



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

Numri i lëndës: 2024:079057  
Datë: 02.05.2024  
Numri i dokumentit: 05646510

**C.nr.78/2024**

**Gjykata Themelore Gjilan - Dega në Kamenicë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, përmes gjyqtarit Artan Abazi, me bashkëpunëtorin Shkurte Kadriu, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.M. nga ....., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Selmon Sadiku, avokat nga Kamenica, kundër të paditurës Komuna e Kamenicës - Drejtoria e Arsimit, me objekt kontesti kompensimin e shpërblimit jubilar, me vlerë të kontestit 315.00 euro, jashtë seancës, me datë 02.05.2024, mori këtë:**

**A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET** në tërësi si e bazuar në ligj kërkesëpadija e paditësit A.M. nga ....., dhe Detyrohet e paditura Komuna e Kamenicës-Drejtoria e Arsimit, që paditësit në emër të shpërblimit jubilar për 20 vite përvojë të punës, shumë prej **315.00 euro** (75 % e vlerës së pagës bazë), me kamatë ligjore prej 8 % nga data e paraqitjes së padisë 23.02.2024, e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të aktgjykimit, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

**II. DETYROHET** e paditura që paditëses t'ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 124.00 euro, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

**A r s y e t i m**

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij me datë 23.02.2024, ka paraqitur padi kundër të paditurës Komuna e Kamenicës-Drejtoria Komonale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimin e pagës jubilar. Në padi ka theksuar se paditësi është i punësuar në SHFMU "Skenderbeu", në fshatin Hogosht, në pozitën e mësimdhënësit, dhe me datë 02.09.2022 i ka mbushur 20 vite të përvojës së punës, andaj të njëjtit për shpërblimin jubilar për 20 vite përvojë punë në lartësi të 75% të pagës bazë prej 421.00 euro, i takojnë 315.00 euro, me kamat ligjore prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, nën kërcënimin e përmbarimit ligjor. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar edhe atë 104.00 euro për përpilimin e padisë si dhe shumë prej 20.00 euro për taksën gjyqësore.

Baza ligjore lidhur me këtë kërkesë ka theksuar se gjendet në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë të dt.18.04.2017 dhe KKAK-së të dt.22.01.2021, në nenin 35 parag.5, 7 dhe 8.

E paditura në përgjigje në padi e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar, me arsyetimin se Komuna e Kamenicës, si e paditur nuk është palë nënshkruese e Kontratës Kolektive të Arsimit të Kosovës, të datës 22.01.2021 (në vijim: KKAK), pasi që e njehta është nënshkruar nga palët Ministria e Arsimit, Shkencës, dhe Teknologjisë (në vijim: MASHT) në njërën anë, dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (në vijim: SBASHK) në anën tjetër, andaj e njehta nuk prodhon efekt juridik ndaj tij si e paditur. Tutje, ka shtuar se kërkesa e paditësit është vjetruar konform nenit 78, pika 1 të Ligjit të Punës, nga shkakut se nuk është adresuar asnjë kërkesë nga paditësja te e paditura si punëdhënëse në procedurë administrative për realizimin e të drejtave të tij lidhur me këtë çështje, përkatësisht nuk i ka shtjerrë mjetet juridike në procedurë administrative ashtu siç parashihet me nenin 79 dhe 82 të këtij ligji. Nga këto arsye i ka propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj si të pabazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave të bashkangjitura padisë, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga e paditura, gjeti se në këtë çështje mes palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, andaj në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (me tej: LPK), gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e themeltë, dhe si rrjedhojë gjykata vendosi pa shqyrtim të çështjes si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Mes palëve nuk është kontestues fakti se paditësi është në marrëdhënie punë tek e paditura, si mësimdhënës në SHFMU “Skenderbeu”, në fshatin Hogosht, K.Kamenicës, me përvojë pune 20 vjeçare, i cili fakt vërtetohet nga vërtetimi nr.221, i dt.16.11.2023, i lëshuar nga SHFMU “Skenderbeu”, në fshatin Hogosht, K.Kamenicës, përmes të cilit vërtetohet se paditësi ka filluar punën me datë 02.09.2002, dhe i njëjti ka përvokë pune gjithsej 21 vite, 5 muaj dhe 12 ditë, po ashtu nuk është kontestuese se paga bazë e paditësit është 421.00 euro, fakt që vërtetohet edhe nga lista e pagës e lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës.

Vërtetimet e lartcekura, gjykata i pranoi si provë materiale vendimtare në kuptim të nenit 329, paragrafi 1 të LPK-së, ngase të njëjtat janë lëshuar nga e paditura brenda fushëveprimit të tij, andaj gjykata vërtetimet si prova me të cilat vërtetohet faktet kryesore për ditët e pranisë në punë, përvojën e punës dhe pagën bazë, ia falë besimin e plotë.

Bazuar në faktet e çështjes, gjykata gjen se në këtë çështje kontestimore e drejta subjektive e paditësi derivon nga KKAK e datës 18.04.2017 dhe e datës 22.01.2021, e lidhur dhe e nënshkruar në mes të palëve MASHT dhe SBASHK, ngase paditësi ka provuar se koha për të cilën kërkon kompensimin e pagës jubilarë pasi që i njëjti me datë 02.09.2022 i ka mbushur 20 vite përvojë pune, është koha kur të dy kontratat kanë qenë në fuqi.

Në KKAK të datës 22.01.2021, në nenin 35, paragrafi 8, pika 8.2 se “Punëtorët (anëtarë të SBASHKUT-ut), në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit, ashtu që për 20 vite të përvojës së punës i kompensohet 75 % të pagës bazë”.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, që përcakton se “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritore, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilin e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”.

Nga vërtetimet e ofruara si provë në këtë çështje kontestimore, gjykata ka provuar faktin se paditësi në vitin 2022, i ka pasur 20 vite përvojë pune, që do të thotë në vitin 2022 e ka arritur vitin jubilar prej 20 vite përvojë pune, pra në kohën kur ka qenë në fuqi Kontrata Kolektive e Arsimit e datës 21.01.2021.

Meqë paga bazë e paditësit është 421.00 euro, gjykata ia njohi lartësinë e kërkesëpadsë të kërkuar si në padi, sipas vlerës së 75 % të një page bazë prej 421.00 euro.

Nga që u tha, bazuar në nenin 398 të LPK-së, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe atë pa caktuar seancë gjyqësore, pasi vlerësoi se në rastin konkret kërkesëpadija ishte qartazi e themeltë, ngase bazohet në dispozitat e KKAK, ndërsa shuma e kompensimit është vërtetuar nga provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Sa i përket kundërshtimeve të të paditurës me përgjigje në padi se KKAK nuk prodhon efekt juridik për të paditurën sepse nuk është nënshkruese e tij ngase e njejta është nënshkruar në mes të palëve MASHT dhe SBASHK, gjykata e vlerëson si të pabazuar, për shkak se KKAK është lidhur në nivel vendi (neni 90 i Ligjit të Punës) dhe e njejta referuar nenit 2 të tij, është e zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet e Arsimit Parauniversitar ku bën pjesë edhe paditësi, si dhe dispozitat e të njejtës janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e arsimit, gjegjësisht komunat-DKA-të, ku në këtë rast është e paditura. Andaj nga se u tha, gjykata vlerëson se e paditura ka përgjegjësi në përmbushjen e detyrimeve të cilat derivojnë nga KKAK. Po ashtu, sa i përket pretendimit të paditurës se paditësja fillimisht nuk i ka shfrytëzuar mjetet juridike në procedurë administrative para se të paraqes padi, gjykata e vlerëson të pabazuar, ngase e drejta e punës si kategori kushtetuese dhe e garantuar me konventa ndërkombëtare dhe me ligj, për kërkesat në të holla që rrjedhin nga marrëdhënia e punës nuk është e nevojshme dhe domosdoshme që paraprakisht i punësuarit t’i drejtohet punëdhënësit me kërkesë për mbrojtjen e të drejtave të tij si kusht themelor për parashtrimin e padsë në gjykatë.

Lidhur me kamatën, gjykata ka vendosur duke u bazuar në dispozitën e nenit 382 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Vendimin që pala e paditur t’i bartë shpenzimet e procedurës gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore konform nenit 449 dhe 452 të LPK-së. Lartësia e këtyre shpenzimeve të aprovuara i referohet shpërblimit për përpilimin e padsë në shumën prej 104.00 euro dhe

Numri i lëndës: 2024:079057  
Datë: 02.05.2024  
Numri i dokumentit: 05646510

taksës gjyqësore për padi në shumën prej 20.00 euro, e në shumën e përgjithshme prej 124.00 euro.

Gjykata, nga të lartëcekurat e bazuar në nenin 143, paragrafi 1 lidhur me nenin 398 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN – DEGA NË KAMENICË**

**Departamenti i Përgjithshëm – divizioni civil**

C.nr.78/2024, më datë 02.05.2024

Gjyqtari,  
Artan Abazi d.v

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit në Gjykatën e Apelit, përmes këtij Gjykate.